



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar"

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Pjerin Ndreu, Elona Hoxha, Antoneta Dhima, Edmond Rushi, Adnor Shameti dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Myslym Murrizi, Paulin Sterkaj, Xhemal Qefalia, Luan Harusha dhe Anduel Xhindi.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendesministre e Brendshme

Emirjola Yzeiraj – përfaqësuese e Sektorit të Marrëveshjeve në MB

Xhevair Karaj - përfaqësuese nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Mirëmëngjesi, kolegë!

Hapim mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare. Sot në rendin e ditës kemi planifikuar vetëm një projektligj, konkretisht projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar".

Për të prezantuar këtë projekt marrëveshje kanë ardhur 3 kolegë të Ministrisë së Brendshme: zonja Rovenë Voda, zëvendësministre e Brendshme dhe zotin Xhevair Karaj, nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit dhe së bashku me ta, është sot e pranishme edhe zonja Emirjola Yzeiraj.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Relatore e komisionit për këtë projektligj është zonja Antoneta Dhima.

Më lejoni që para se t'ia jap fjalën zonjës Voda për të prezantuar këtë marrëveshje të rëndësishme që ka të bëjë me ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, t'i uroj mirëseardhjen kolegut Rushi. Më herët i janë bashkuar komisionit edhe zoti Maliqi, edhe zoti Shehu.

Punë të mbarë, kolegë!

Zonja, Voda, fjala është për ju për të na prezantuar se çfarë sjell kjo projekt marrëveshje dhe se cilat do të jenë të mirat që do të përfitojnë qytetarët shqiptarë të të 2 vendeve.

Rovenë Voda – Faleminderit, kryetare!

Projektakti që propozohet sot në komision për miratim është iniciuar në kuadër të angazhimeve të përbashkëta të të 2 qeverive (qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës), me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave dhe të masave të lidhura me kontrollet kufitare në përgjithësi dhe të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve.

Marrëveshja është iniciuar duke marrë parasysh fluksin në rritje të qarkullimit të shtetasve dhe të mallrave ndërmjet dy vendeve tona, kryesisht gjatë sezonit veror ku radhët janë shumë të gjata, me vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin, për lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve dhe të mjeteve.

Në fakt nuk është hera e parë që ne si ministri po kalojmë një marrëveshje të tillë. Kemi pasur eksperiencë të tillë që në vitin 2008 me Malin e Zi me pikën e Murriqanit. Eksperienca ka qenë shumë pozitive, duke lehtësuar kalimin e qytetarëve dhe të mjeteve.

Parimi që zbatohet është parimi: “Një ndalesë, një kontroll”, pra do të ketë vetëm kontroll në hyrje të të dy vendeve, duke shmangur kontrollet e dyfishta. Kjo marrëveshje vjen në kohë dhe me një investim të madh të kryer nga delegacioni i BE-së.

Ju, zonja kryetare dhe deputetët e komisionit tuaj keni qenë shumë aktivë dhe keni pasur rastin të shihni nga afër edhe pikën e Morinës, siç janë edhe pikat e tjera të kalimit kufitar. Aty është bërë një investim, është shtuar numri i korsive. Nga 6 korsi janë dyfishuar, pra tani kemi 12 korsi që janë të ndara: 6 për ne dhe 6 për palën kosovare, duke ushtruar parimin një ndalesë, një kontroll. Ka një investim të Komisionit European për një godinë të përbashkët, ku do të qëndrojnë autoritetet policore dhe doganore të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Unë mendoj se anët pozitive të kësaj marrëveshjeje janë në lehtësimin e qarkullimit, të shërbimit ndaj qytetarëve të të 2 vendeve, duke ulur flukset, sidomos gjatë periudhës së verës.

Unë mendoj se kjo është një marrëveshje që përveç Morinës të mund të replikohet edhe në pika të tjera të kalimit kufitar me Kosovën. Aktualisht, them në Morinë, sepse ka filluar, pra pavarësisht se po e kalojmë sot në komisionin tuaj që është edhe komision përgjegjës, lejohet me një marrëveshje të përbashkët që të fillojë të aplikohet. Deri tani ka dhënë rezultat, e ka përgjysmuar kohën e kontrollit në të dyja anët e kufirit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Voda!

Në fakt, ne kemi pasur rastin të vizitojmë një pikë të kalimit të përbashkët kufitar atë të Qafë Thanës dhe përveç anës pozitive infrastruktura atje pas kaq vitesh linte për të dëshiruar dhe ne kemi bërë me dije edhe ministrin e Brendshëm, edhe më tej, që në përgjithësi të gjitha pikat e kalimit kufitar meritojnë ndërhyrje në infrastrukturë. Sa më e denjë të jetë infrastruktura, aq më shumë kuptim do të marrin edhe marrëveshjet ndërmjet 2 vendeve për të ofruar një shërbim

të përbashkët, i cili shkurton kohën, duke rritur numrin e njerëzve që lëvizin nga të dyja anët e kufirit. Në fund të ditës, natyrisht që kjo është edhe në dobi të ekonomisë publike.

Ia jap fjalën zonjës Dhima dhe më pas kolegët mund t'u bëjnë pyetje përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme apo relatores.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre e Brendshme për prezantimin e projektligjit!

Projektakti që propozohet për miratim është iniciuar në kuadër të angazhimeve të përbashkëta të të dyja qeverive, me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave dhe të masave të lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve.

Marrëveshja është iniciuar, duke marrë parasysh fluksin në rritje të qarkullimit të shtetasve dhe të mallrave ndërmjet dy vendeve tona, vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin, si dhe synimin për arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit rajonal dhe atij europian.

Marrëveshja parashikon që pikat aktuale jo të përbashkëta të kalimit kufitar të ndryshojnë statusin në pika të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërsa pikat e kalimit kufitar që mund të hapen në të ardhmen do të rregullohen sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.

Gjithashtu, kjo marrëveshje nuk ndikon marrëveshjen për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar në Shishtavec, Borje dhe Orgjost.

Nisur nga fakti se disa prej pikave të kalimit kufitar janë pika të kalimit kufitar për qarkullim lokal, ku nuk parashikohet qarkullim ndërkombëtar i mallrave, por vetëm i shtetasve, është vlerësuar që autoritetet kompetente për zbatimin e saj të parashikohen në protokollet, që do të nënshkruhen, pas miratimit të kësaj marrëveshjeje.

Përparësitë që priten nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje janë, si më poshtë vijon:

- Lehtëson qarkullimin e shtetasve dhe të mjeteve gjatë kalimit të kufirit, si në pjesën e regjistrimit dhe në pjesën e kontrollit;

- Kontrolli dhe verifikimi kufitar kryhen të përbashkët dhe për pasojë minimizohet koha e përpunimit të të dhënave të shtetasve dhe mjeteve gjatë kalimit të kufirit;

- Rrit bashkëpunimin për përmbushjen e interesave të përbashkëta të sigurisë;

- Rrit bashkëpunimin midis palëve në menaxhimin e kontrollin e kufirit dhe njëkohësisht përmirëson shkëmbimin e shpejtë të informacionit;

- Rrit dhe intensifikon më tej bashkëpunimin policor.

Në kushtet kur ka kaq përparësi nga miratimi i kësaj projektmarëveshjeje, i ftoj të gjithë kolegët deputetë ta miratojmë atë!

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Dhima!

Kush ka pyetje apo diskutime nga kolegët?

Zoti Ndreu keni fjalën!

Pjerin Ndreu - Faleminderit!

Unë personalisht, jam dakord që të lehtësohen procedurat, sidomos me Kosovën, por desha të di: në vlerësimin tuaj situata në pikën e Morinës që është tashmë me një shërbim i integruar, një sistem të përbashkët, çfarë efekti ka pasur? Duke parë disa kronika televizive, disa nga shqetësimet që kanë ngritur kaluesit e asaj, por, në fakt, edhe me çfarë kam parë unë, situata nuk është aq pozitive sa është dhënë. Pra, ka një komplikim të mëtejshëm të radhës së makinave dhe të shpejtësisë së shërbimit. Duke i futur të dyja shërbimet në një kabinë, më duket se e ka agravuar më keq situatën sesa kur ishte shërbimi në njërin krah. Pra, nuk është përfituar asgjë. Si e vlerësoni ju këtë gjë? Nëse i njëjti stil shërbimi shkon në të gjitha pikat e kalimit kufitar, atëherë ngelet për t'u parë se cili ka qenë vlerësimi: a do të përfitojmë realisht, apo do ta ngatërrojmë më keq situatën?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Besoj se pyetja është e qartë. Meqenëse është rasti i parë i fillimit të një pune të përbashkët ndërmjet shteteve të ndryshme për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, si mund t'i përmirësojmë edhe marrëveshjet, në mënyrë që ato të reflektohen edhe te shërbimet në këto pika?

Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Faleminderit, zoti Ndreu!

Në fakt, unë do të thosha se ka pasur një shqetësim të tillë në fillim, siç e paraqiti zoti Ndreu dhe, pavarësisht se ne e nënshkruam këtë marrëveshje sipas parimit “një ndalesë – një kontroll”, iu kërkua, në fakt, palës kosovare dhe pati një lloj presioni. Të mos harrojmë që me

status, në drejtim të procesit të hapjes së negociatave, ne jemi një hap më para se ata. Pra, ata janë një vend, që dëshiron të hyjë si vend kandidat, madje procesi i liberalizimit të vizave, pavarësisht se ka kaluar në Parlamentin European, ende nuk është miratuar në KE.

Pati një lloj presioni që të mos bëhej hyrje – hyrje, pra e njëjta procedurë, por të vazhdonte kontrolli i dyfishtë.

Pavarësisht se kjo marrëveshje u nënshkrua, është e vërtetë se në fillim nuk...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e pati.

Pra, hyrjet ishin në një kabinë, por bëhej kontroll i dyanshëm nga të dyja palët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pasi u vlerësua dhe u bë një takim i të dyja palëve, i të dyja policive kufitare, me një vullnet të përbashkët, u vendos përfundimisht ajo çfarë është parashikuar në këtë marrëveshje, domethënë të ketë vetëm një kontroll, që do të thotë hyrje – hyrje. Pra, nuk ka më kontroll të dyfishtë.

Nuk e vonon procesin fakti që janë dy punonjës në një kabinë, se kështu është edhe në Muriqan, pra shihet se polici ynë kufitar me atë të Malit të Zi janë në të njëjtën kabinë.

Po të shikojmë pamjet dhe ankesat që vijnë, mund të vërejmë disa radhë të gjata të kamionëve, të *truck-eve* të mëdhenj. Këtu, në fakt, nuk është problemi i policisë kufitare, pra nuk kemi të bëjmë me vonesën që ndodh në kontrollin kufitar, por kjo ka sjellë, po themi, shtimin e fluksit të kamionëve, duke krijuar edhe përshtypjen: “More, çfarë po bëjmë, se përsëri radhët i shohim të gjata?!”.

Kemi terminalin doganor, i cili është një investim që do ta bëjnë doganat, pra jo Policia e Shtetit, ku duhet të qëndrojnë automjetet pasi kalojnë pjesën e skanimit, sepse ju e dini që gjithsesi kalojnë në skaner dhe krijohet ky konfuzioni deri sa të mbarojë terminali doganor.

Ajo çfarë ne po u kërkojmë doganave dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm është që ky terminal, pra sheshi atje, të mbarojë sa më parë, që të mos krijohet ideja ose realisht pamja e frikshme e radhëve të gjata të kamionëve që rrinë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, kjo sjell edhe një problem tjetër. Në momentin kur kamionët kalojnë për t’u futur në radhë dhe nuk rrinë të stacionuar në terminal, shpeshherë u presin rrugën edhe

automjeteve të vogla të njerëzve që qarkullojnë, duke krijuar ndonjëherë pengesa në kalimin e automjeteve që e kalojnë kontrollin. Mund të themi se aty duhet urgjentisht finalizimi i investimit nga ana e doganave për pjesën e terminalit doganor, që besoj se pastaj situata do të jetë më e qetë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Dua t'ju sqaroj një detaj: analogjia me Malin e Zi nuk ka lidhje me rastin në fjalë, pasi po flasim për Kosovën. Specifikat që sjell një marrëveshje ndërmjet dy qeverive për dy vende shqiptare është një tjetër, ndërsa ajo me Malin e Zi është tjetër gjë. Pra, konstatohet një shqetësim i të gjithë kaluesve që kalojnë aty, sepse procedurat janë komplikuar, nuk janë lehtësuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është e vërtetë, sepse e kam hasur edhe vetë, madje ka një stërmundim për të kaluar aty nga një histori, e cila ishte shumë më e lehtë më parë: kaloje në njërin krah, ndërkohë që krahun tjetër ishte i lirë dhe gjithkund në hyrje... Domethënë, futeshe në territorin e Kosovës, kontrolloheshe në Kosovë; futeshe në Shqipëri, kontrolloheshe në Shqipëri.

Për mua, qoftë edhe si përdorues i asaj pike kufitare, ka qenë më e lirë dhe më funksionale siç ishte më parë sesa kjo që u bë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo situatë është e prekshme nga vetë ne.

Ermonela Felaj – Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e pranova se është e vërtetë, pra ka qenë ky shqetësim. Nuk e di se kur ka qenë zoti Ndreu për herë të fundit në atë pikë kufitare, por unë kam qenë fiks para gjashtë ditësh në Morinë për vizitë. Ishte njëlloj si në Muriqan: bëhej vetëm një kontroll nga njëra palë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam qenë në Morinë te pjesa e automjeteve pikërisht për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ndreu, ajo çfarë m'u tha nga shefi i stacionit të policisë sonë kufitare atje ishte pikërisht shqetësimi se krijohen radhët e gjata të kamionëve te pjesa që i përket edhe pjesës së kontrollit doganor, por te pjesa jonë gjithçka është e normalizuar. Këtë mund ta verifikoni.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Voda!

Në qoftë se mund të thellohem pak te pyetja dhe përgjigjet lidhur me atë që tha zoti Ndreu, në Muriqan kemi konstatuar se mungon skanimi i automjeteve sipas kontratës së lidhur nga RAPISCAN-i. Pra, jo në çdo pikë të kalimit kufitar ka edhe skanim dhe normalisht kjo sjell probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe te kontrolli, sepse kontrolli për disa lloj mjeteve bëhet i pamundur dhe situata bëhet shumë e vështirë pastaj.

Nuk e di si parashikohet ose a ka qenë në vëmendjen e Ministrisë së Brendshme kjo gjë, që pikat e skanimit të shtrihen edhe në terriore të tjera, ku, në fakt, fluksi i mjeteve është i madh? Ju e dini që Muriqani përdoret më shumë për tregtinë, për transport sesa për kalimin e udhëtarëve.

Rovena Voda – Në fakt, pjesën e skanimit, si të thuash, nuk e mbulon... Domethënë, ju e dini se pjesa e policisë kufitare e Ministrisë së Brendshme është Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Ne kemi kërkuar, në fakt, nga doganat, meqenëse edhe ju e dini se pikat janë të përbashkëta pikat kufitare dhe doganore, që të pajisen me skaner të gjitha pikat kufitare.

Megjithatë, me sa po më thotë edhe drejtori i Kufirit, zoti Karaj, kohët e fundit, pas mbarimit të investimit në Hanin e Hotit, për pjesën e kontrollit të mallrave po përdoret më shumë pika kufitare e Hanit të Hotit (pra për kamionët e mëdhenj), ndërsa Muriqani po përdoret më shumë nga udhëtarët (pra nga automjetet e vogla).

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk besoj se sjell ndonjë shqetësim.

Megjithatë, aty ku nuk ka, bëhet një lloj kontrolli mbi bazën e një analize risku. Pra, doganat kanë një lloj analize risku...

Ermonela Felaj – Hani i Hotit nuk ka skaner.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rovena Voda – Po bëhet një lloj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë po i them edhe kryetares që, në fakt, ne u kemi kërkuar doganave të çojnë një skaner atje. Ata e kanë premtuar dhe kanë thënë: “Po, do ta dërgojmë”, por të shohim tani... Gjithsesi, bëhet një lloj kontrolli në bazë, e theksoj, të një analize risku. Aty ku mendohet se ka risk, duke parë ndoshta në sistemin TIMS edhe të dhënat e drejtuesit të automjetit apo edhe të dhënat e mjetit, kalohet mjeti, siç e dini, për kontroll në vijën e dytë, ndoshta për një kontroll më të imtësishëm.

Për momentin ecet me analizë risku, por është kërkuar që të ketë skanerë në të gjitha pikat kufitare.

Ermonela Felaj – Unë besoj që duhet ta ngrini më lart nivelin e kërkesës, në kuptimin që shtrirja e marrëveshjes koncesionare duhet të jetë kërkesë e institucionit, edhe në këto pika, për arsyen e thjeshtë dhe të vetme, që të gjithë kamionët e paguajnë tarifën e skanimit pavarësisht nëse koncesionari ka hapur pikë apo jo. Këtë gjë ne e kemi hasur në pikën kufitare të Hanit të Hotit. Pavarësisht se është një problem që impaktin doganat, nuk e lë jashtë Policinë e Shtetit, sepse të dhënat e kontrollit i interesojnë Policisë së Shtetit. Përfitojmë nga rasti, t’ju kërkojmë që ta shikoni në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe qeverinë që kjo të ndodhë sa më shpejtë të jetë e mundur.

Fjalën e ka zoti Duzha.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Si do të bëhet kalimi i shtetasve shqiptarë, do të kontrollohen nga pala shqiptare apo ajo kosovare?

Së dyti, si do ta bëjë punonjësi i doganës kontrollin doganor, sepse një automjet i vogël mund të transportojë mallra kontrabandë?

Faleminderit!

Xhevahir Karaj – Përsëritje të gjithëve!

Aktualisht, në pikën kufitare të Morinës kemi një kontroll. Pra, ne bëjmë kontrollin e dokumentacionit të udhëtarit në hyrje, kurse pala kosovare bën kontrollin e dokumentacionit në

hyrje nga ana e tyre. Nuk ka kontroll në dalje. Pra, ne kontrollojmë ata që hyjnë në Shqipëri, kurse ata kontrollojnë ata që hyjnë në Kosovë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo marrëveshje që është sjell sot këtu e zgjidh njëherë e mirë problemin e radhëve, që ngriti deputeti, sepse do të ketë vetëm një ndalesë. Dy punonjësit e policisë, yni dhe i Kosovës, do të jenë në një sportel, siç janë aktualisht në pikën kufitare të Muriqanit. E merr dokumentacionin ai që është i pari, më pas ia kalon kolegut dhe në fund i merr qytetari dhe largohet. Nuk ka dy ndalesa, por një ndalesë. Këtë gjë po bëjmë edhe për pikën kufitare të Morinës dhe të gjitha pikat e tjera që janë në kufi me Kosovën. Pika kufitare e Muriqanit shërben vetëm për kalimin e mjeteve të vogla dhe të udhëtarëve, kurse pika kufitare e Hanit të Hotit shërben për kalimin e mallrave, mjeteve, udhëtarëve. Ne kemi kërkuar që të vendoset një skaner në pikën kufitare të Hanit të Hotit, sepse atje është ngarkesa më e madhe e qarkullimit. Dy janë pikat më të ngarkuara për sa i përket lëvizjes së njerëzve dhe transportit të mallrave, Hani i Hotit dhe Morina. Ata po e diskutojnë, ne e kemi çuar kërkesën deri në nivel ministri dhe jemi në pritje të vendosjes së një skaneri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Duzha!

Faleminderit, zoti Karaj!

Fjalën e ka zoti Xhindi.

Anduel Xhindi – Faleminderit, zonja kryetare!

Si bëhet shkëmbimi i informacionit me policinë, pasi, me sa di, ato janë dy sisteme të ndryshme? A ka ndonjë marrëveshje me Malin e Zi apo Maqedoninë për hapjen e ndonjë pike tjetër të përbashkët kufitare?

Xhevahir Karaj – Për sa i përket pyetjes së parë, kjo është zgjidhur në vitin 2009 kur është bërë për herë të parë kontrolli hyrje-hyrje në pikën kufitare të Morinës. Pra, nëpërmjet specialistëve tanë të IT-së dhe specialistëve të tyre është bërë i mundur shkëmbimi i informacioneve nga sistemi ynë te sistemi i tyre brenda 24 orëve. Pra, nëse unë kaloj sot, brenda 24 orëve emri im duhet të shfaqet në sistemin e palës tjetër ose anasjelltas.

Aktualisht nuk kemi projekt marrëveshje me Maqedoninë dhe Malin e Zi për pika të tjera. Me Malin e Zi kemi marrëveshje për pikën kufitare të Muriqanit, kurse për pika të tjera nuk kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me Maqedoninë dhe me Greqinë problemet ecin pak më ngadalë sesa me Malin e Zi dhe me Kosovën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë në proces, por në kuadrin e diskutimeve.

Ermonela Felaj – Po, zoti Maliqi.

Lefter Maliqi – Faktikisht kisha 2-3 pyetje, por për bëj vetëm 1. Meqë u bë pikë e përbashkët dhe është arritje, a ka ndryshuar struktura organike e Policisë Kufitare të Shqipërisë?

Xhevahir Karaj - ... do të ndryshojë edhe struktura. Mementalisht, si struktura jonë, ashtu edhe e Kosovës janë të pandryshuara.

Ermonela Felaj – Besoj se doje të dije nëse do të rritej apo ulej numri i punonjësve? Si parashikohet kjo gjë, duke u nisur nga eksperiencia tjetër në pikën kufitare të Hanit të Hotit?

Xhevahir Karaj – Aktualisht, në pikën kufitare të Morinës ne kemi 47 efektivë, kurse Kosova ka 74 efektivë. Kjo do të thotë që ne pretendojmë ta rrisim numrin e punonjësve të policisë që do të shërbejnë në këtë pikë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Karaj!

Po, zoti Shehu.

Ylli Shehu – Faleminderit!

Ju thatë që në pikën doganore të Morinës është përmirësuar shërbimi, por po afron periudha e sezonit veror dhe nuk kemi mundësi ta testojmë. A keni marrë masa të tjera, sepse edhe në këto ditë ne hasim vështirësi. Unë e frekuentoj shumë atë rrugë dhe kam vënë re që është shumë problematike. Kur ne i hasim sot këto probleme, si mendoni se do të jetë gjatë sezonit veror? A ka ndonjë marrëveshje, sepse fluksi do të jetë më i madh se në këto ditë?

Xhevahir Karaj – Me miratimin e këtij projektligji do të zgjidhet edhe kjo çështje. Po shpejtojmë ta zgjim sa më shpejtë në mënyrë që të bëhet para sezonit turistik. Pra, do të ketë vetëm një ndalesë në një pikë të përbashkët.

Ylli Shehu – Ne e kemi parë që është me një ndalesë, por përsëri kemi hasur në këto probleme. Kjo është testuar në këtë periudhë, por jo në periudhën e verës që do të ketë fluks më të madh.

Xhevahir Karaj - Ju keni të drejtë, por forma e ushtrimit të kontrollit është “kontroll hyrje-hyrje”, kurse miratimi i kësaj marrëveshjeje do të bëjë që të dy shërbimet të bëhen në një sportel.

Ermonela Felaj – Do ta monitorojmë pas hyrjes në fuqi këtë marrëveshje. Në pikën kufitare të Morinës nuk kemi qenë, ndonëse kemi qenë në pjesën më të madhe të pikave të kalimit kufitar në vend. Natyrisht, kjo është një pikë e madhe dhe është e rëndësishme që çdo gjë të shkojë mbarë edhe në atë pikë, aq më tepër që frekuentohet nga shtetas shqiptarë dhe dihet që me hapjen e sezonit turisti, deri në mbyllje të tij, ngarkesa atje është e lartë.

Ermonela Felaj – Faleminderit për të gjitha pyetjet dhe përgjigjet!

Kalojmë në miratimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit kolegë!

Faleminderit kolegëve të Ministrisë së Brendshme!

Ju njoftoj që nesër në orën 11:00 kemi planifikuar një vizitë në Drejtorinë e Policisë Tiranë.

Kemi ruajtur gjatë gjithë këtij sesiioni një qasje tjetër në raport me institucionet e sigurisë dhe të rendit në vend. Pjesë e kësaj qasjeje është edhe të qenit pranë tyre për të kuptuar se si ato funksionojnë. Besoj se tema kryesore që do të diskutojmë nesër në Drejtorinë e Policisë Tiranë do të jetë kriminaliteti në kryeqytetin e Shqipërisë për vitin që shkoi, si edhe të dhëna të tjera të punës apo nevojave që ka struktura e policisë në qytetin më të madh të Shqipërisë.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA